

NIKO NAKO



Auditues i Lartë, Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, KLSH.

Lindur në vitin 1954. Diplomuar në Ekonomi, dega Kontabë(1977) dhe në Jurisprudencë(1977). 38 vite eksperiencë pune.

20 vitet e fundit auditues në KLSH.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i të ardhurave të pushtetit vendor

AUDITIMI I ADMINISTRIMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDOREⁱⁱⁱ

nga Niko Nako

*Tatimi është ajo pjese e pasurisë të cilën çdo qytetar ia jep shtetit me qëllim që të ruajë (të ketë siguruar) pjesën tjetër të saj.

Monteskje

- Ligje dhe udhëzime që janë shumë të mira por nuk zbatohen, sa nga neglizhenca apo edhe nga mosnjohja-

Kuadri ligjor ku mbështet Kontrolli i Lartë i Shtetit në lidhje me auditimin e administrimit të taksave dhe tarifave vendore, shërben ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes vendore” dhe konkretisht neni 22 ku në mënyrë eklpicite shkruhet se; Çdo Njësi e Qeverisjes Vendore i nënshtrohet kontrollit të **jashtëm financiar të Kontrollit të Lartë të Shtetit**, për ligjshmërinë e përdorimit të burimeve financiare.

Në këtë kuadër edhe KLSH për secilin vit në planin vjetor të auditimit parashikon dhe ushtron auditim në rreth 40-50 Njësi të Qeverisjes Vendore (Bashki, Komuna, Këshilla Qarqesh)

Me decentralizimin e disa kompetencave në lidhje me vendosjen e disa taksave dhe tarifave vendore dhe grumbullimin e tyre, shtohet dhe përgjegjësia e Njësive të Qeverisjes Vendore, në drejtim të krijimit të strukturave për zbatimin e tyre, mbledhjen e taksave dhe rritja e kapaciteteteve administrative.

Llojet e taksave dhe tarifave vendore janë të shumta, **por problem është mos grumbullimi i tyre**, e cila përveç neglizhencës së punonjësve të ngarkuar me mbledhjen e tyre, (zyrat e taksave vendore), vjen edhe nga mos njohtësia, apo në disa raste mos zbatimi i akteve ligjore të nxjerra nga Kuvendi i Shqipërisë, apo Këshillat e Njësive të Qeverisjes Vendore (Këshillat Bashkiake apo të Komunave).

Mos regjistrimi i subjekteve në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)

Nga auditimet e kryera në mjaft Bashki dhe sidomos Komuna, ende mjaft subjekte ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKR dhe organet tatimore (Zyrat e Taksave Vendore).

Këto subjekte, nga njëra anë, përveç se nuk paguajnë taksa dhe sigurimet shoqërore (kryejnë evazion fiskal), nga ana tjetër kryejnë konkurrencë të pandershme, duke shitur me çmime të ulta. Dhe në këtë rast e pëson subjekti që është i regjistruar dhe paguan rregullisht taksat. Në këtë drejtim ka mjaft neglizhencë apo ka raste që qytetarët nuk u binden rregullave dhe nuk pranojnë të regjistrohen.

Edhe pse nga ana e administratës tatimore vendore dihet se subjektet e paregjistruara në QKR, kryejnë aktivitet në kundërshtim me ligjin, **atyre nuk u mbyllet veprimtaria**, duke vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920,

datë 10.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 10,415, datë 07.04.2011, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar, ku në pikën 1, të ligjit mësipërm në mënyrë eksplicite shkruhet se: Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, atyre u mbyllet veprimtaria dhe u konfiskohen të gjitha materialet, sipas nenit 121 të këtij ligji.

Nga auditimet e KLSH, subjekte të paregjistruara, janë konstatuar në Bashkitë; Fier, Klos, Bulqizë, Komunën Libofshë, etj.

Sipas nenit 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" Për Procedurat tatimore", për subjektet e paregjistruara në QKR, mund të vendoset edhe masa e **gjobës prej 25,000 lekë**, por këtë masë ligjore, pak administrata tatimore e zbatojnë. Kështu nga auditimet e kryera nga KLSH, rezulton se këtë masë e ka zbatuar Bashkia Pogradec, por nuk e pranon Bashkia Fier. Ndoshta pasi edhe ky nen ka nevojë të interpretohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Mbledhja e taksave nga tatim paguesit (subjektet private, apo edhe Institucione shtetërore), përbën një nga problemet më shqetësuese të zyrave të taksave vendore. Për arkëtimin e tyre është e angazhuar e gjithë administrata tatimore, por megjithëse punën e bërë dhe "presionin" që ushtrohet mbi ta, ende një pjesë e mirë e tyre nuk pranojnë ta paguajë. Por a njihen instrumentet ligjore për të paguar taksat në afat për subjektet e pa " bindur"?, përgjigja është disa i njohin, disa nuk i njohin. Por edhe nëse i njohin, a zbatohen ato ?, përgjigja është JO.

Pavarësisht se mbledhja e taksave vendore është detyrë e administratave të pushtetit vendor, por edhe KLSH që mbikëqyr zbatimin e ligjshmërisë, jep

sadopak ndihmesën e saj, duke i vënë në lëvizje administratat tatimore vendore për zbatimin e ligjit.

Ne rastet kur nuk paguhen taksat, ka dispozita ligjore shtrënguese:

Dërgimi i urdhër bllokimeve për detyrimet tatimore në bankë

Gjatë auditimeve veprimtarisë së përditshme vihet re se mjaft subjekte edhe pse nuk shlyenin detyrimet tatimore, ata kryejnë rregullisht veprimtari nëpërmjet bankave, pra kishin mundësi shlyerje, por u shmangeshin pagesave të taksave. Për t'u ardhur në ndihmë organeve tatimore nga ana e Kuvendit në ligjin për Procedurat Tatimore u shtuan edhe disa nene, për rastet kur **subjektet nuk pranojnë të paguajnë në mënyrë vullnetare taksat dhe tatimet dhe konkretisht** në lidhje me;

- dërgimin e urdhër bllokimeve në bankë, për llogaritë bankare
- vendosjen e bares siguruese ndaj mjeteve të regjistruara në Drejtoritë rajonale të transporteve dhe
- pasurive të paluajtshme në Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme,

Por, edhe pse dispozitat ligjore që detyron bankat të bllokojnë llogaritë në bankë, kur subjektet janë debitorë për taksat dhe tatimet, ato nuk zbatohen nga administratat tatimore. Kjo vjen sa nga neglizhenca e tyre dhe më tepër edhe nga mos njohja e kësaj dispozite nga disa prej administratave të zyrave të taksave vendore në Bashki dhe Komuna.

Gjatë auditimeve të KLSH, në rekomandimet e tij për përmirësimin e punës të Bashkive apo Komunave të audituara ka zënë vend edhe rekomandimi për dërgimin e urdhër bllokimeve në bankë.

Gjatë auditimeve të KLSH, konstatohet se një pjesë e investitorëve të cilët janë pajisur me Leje ndërtimit, banesash, apo lokalesh, etj, nuk kanë paguar taksen e ndikimit ne infrastrukture. Pasi këto raste evidentohen nga KLSH, i rekomandohet Bashkive për arkëtimin e tyre. Bashkitë u bëjnë me dhjetëra njoftime personave debitorë për pagimin e kësaj takse, por një pjesë e tyre nuk pranojnë të paguajnë.

Gjatë auditimit ,KLSH, ka rekomanduar që këto lloj detyrimesh pavarësisht se llogariten nga Zyrat e urbanistikës, si agjent tatimor, por ato janë taksa vendore, dhe për vjeljen e tyre Bashkitë mund të dërgojnë urdhër bllokimit në bankë. Kështu mund të përmendim Bashkinë Pogradec e cila ka 13,000,000 lekë taksa të papaguara nga ndikimi në infrastrukturë, apo Bashkia Bulqizë e cila edhe mbi 8,000,000 lekë, taksa, pa u paguar. Ja pra si KLSH pasi e bëri prezent, fenomenin ku ligji nuk njihej plotësisht dhe u bë fakt, pra u dërguan apo janë në proces dërgimi të urdhrave të bllokimit të llogarive në Bankë.

Edhe ne si auditues ndjejmë kënaqësi kur një rekomandim i joni me 3-4 rreshta që u është lënë subjekteve për dërgimin e urdhrave të bllokimit në Bankë ka dhënë efektivitet. Kështu nga dërgimi i urdhrave të Bllokimit në banka, Bashkitë Fier dhe Burrel kanë arkëtuar me miliona lekë. Por kjo nuk ka ndodhur me Bashkitë Bulqizë dhe Klos të cilat kanë me miliona lekë detyrime tatimore dhe ende nuk u kanë dërguar urdhrat e bllokimit në Bankë.

KLSH, si agjent i Parlamentit, ka rolin edhe të dhënies së përvojës, pasi punonjësit e taksave vendore shpesh ndryshohen dhe nuk e kanë përvojën dhe njohuritë e nevojshme për legjislacionin fiskal.

Vendosja e bares siguruese pranë Drejtorive Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme)

Në se subjektet nuk paguajnë detyrimet tatimore, nga ana e administratës tatimore vendore, kërkohet Vendosja e bares siguruese pranë Drejtorive Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën e Regjistrimit të Paluajtshme (për pasurinë e paluajtshme). Edhe kjo dispozitë ligjore nuk njihet nga administratat tatimore dhe për pasojë nuk zbatohet. Prandaj **rikujtojmë se**, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore”, dhe konkretisht në nenin **91, parashikohet se**: “Nëse tatim paguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 (**njoftim dhe kërkesa për të paguar**), detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, ne masën e nevojshme për të përmbushur detyrimin tatimor të tij”

Penalite dhe masat shtrënguese ligjore, bllokimi i aktivitetit apo dhe kallzimet penale (fshehja e taksave dhe tatimeve, apo mos pagimi në afat i tyre)

Në ekonominë e tregut, që të funksionojë Shteti, ai do të mbahet nëpërmjet taksave dhe tatimeve. Por a paguhen rregullisht ato? Përgjigja është se një pjesë e subjekteve janë të ndërgjegjshëm dhe paguajnë rregullisht taksat. Por gjatë auditimeve të KLSH, janë konstatuar se në disa Bashki dhe Komuna, ka subjekte që nuk paguajnë 2-3 vite radhazi asnjë lek. **Çka është e padrejtë dhe e paligjshme.**

Për të mos e lënë në dorën e subjekteve pagimin e taksave, pasi disa prej tyre edhe pse i kanë mundësitë financiare për të paguar, nuk pranojnë të

paguajnë, vjen në ndihmë Kodi Penal. Edhe kjo dispozitë ligjore, pak njihet apo nuk njihet fare, pasi janë të rralla ose pothuajse fare, rastet, që nga ana e Bashkive apo Komunave, për subjektet që nuk paguajnë me vite, të kërkohet Kallëzim Penal, në Prokurori.

Edhe për mos pagimin e taksave ekzistojnë instrumente shtrëngues të Shtetit të cilat janë:

Nga ana e strukturave të administratës së taksave vendore, për rastet kur kemi fshehje apo mos pagim e taksave dhe tatimeve në afatet e përcaktuara, në Kodi, Penal të Republikës së Shqipërisë, *Miratur me ligjin nr. 7895 datë 27.1.1995 dhe ndryshuar me ligjin nr.8204, datë 10.4.1997, ndryshuar me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, ndryshuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, janë parashikuar 3 nene të cilat, nuk zbatohen apo nuk njihen dhe konkretisht:*

- Neni 180- **Fshehja e të ardhurave.** Fshehja apo tregimi i rremë i të ardhurave ose i objekteve që i nënshtrohen tatimeve dhe taksave, kur më parë janë marrë masa administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet.

-Neni 181 -**Mospagimi i taksave dhe tatimeve.** Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

-Neni 181/a **Moskryerja e detyrave nga organet tatimore** (*Shtuar me ligjin nr. 8279, datë 15.1.1998, neni 2*) Moskryerja e detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë që janë ngarkuar me këto detyra, kur bëhet për fajin e tyre dhe i sjell shtetit dëm në vlerë më të vogël se 1 milion lekë, dënohet me gjobë deri në 2 milionë lekë; kur vlera është më e lartë se 1 milion lekë dënohet nga 3 deri në 10 vjet burgim.

Pagesën e taksës së pastrimit e ka zgjidhur vetëm Bashkia e Tiranës nëpërmjet Ndërmarrjes së Ujësjetës sh.a, ndërsa në Bashkitë e tjera nuk e kanë të mundur grumbullimin e taksave, nga popullata, **pasi mungojnë strukturat për mbledhjen e tyre**, ndoshta duhet të rikthehen me agjent tatimor në ÇEZ-et, apo sportelet e ujësjetësve sha. në rrethe.

Këto probleme janë të përcaktuara në Dispozitat ligjore, përkatëse, si; Ligji Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe udhëzimi i dalë në zbatim të tij; Ligji për Sistemin e Taksave vendore, Rregulloret apo Statutet e Njësive të Qeverisjes Vendore, Kodin Penal. I trajtova në radhë të parë si auditues i Kontrollit të Lartë të Shtetit, por edhe si qytetar, që kontribuoj me tatimet që derdh çdo muaj në buxhetin e shtetit dhe më ndalet taksa e pastrimit, por që nuk paguajmë taksat e tjera të ndërtesave, **pasi nuk na troket kush në derë që të paguajmë.**

Pse mbledhen taksat e makinave dhe gjobat e vogla deri 500 lekëshe, të vendosura ndaj drejtuesve të mjeteve, në çdo skaj të Republikës, madje shteti ka investuar me miliona lekë për vendosjen e kamerave, radarëve, etj?, kurse me miliona lekë taksa vendore nga popullata nuk paguhen, që do të thotë 1m2 rrugë më pak, 1 ujësjetës më pak, etj. **Përgjigja është e qartë, pasi nuk janë krijuar strukturat e mbledhjes së tyre, ka mos njohje të ligjeve, nuk ka sensibilizim të popullatës, nuk zbatohet ligji.**

Ftoj median, si të shkruar edhe atë vizive, sidomos TVSH, për të cilët shqiptarët paguajnë taksa, radiot Lokale, të cilat dëgjohe nga një audiencë e madhe dhe japin një kontribut në bërjen prezent të ligjit dhe ndërgjegjësimin e njerëzve që të paguajnë taksat, për të hapur një emision apo rubrikë për trajtimin e problemeve ekonomike dhe veçanërisht për grumbullimin e

tatimeve dhe taksave vendore. Të mos harrojmë se ne Greqi, një nga elementët gërryes të ekonomisë greke ka qenë korrupsioni dhe mosfunksionimi i strukturave të kontrollit, që ka sjellë dhe mospagimin e taksave dhe tatimeve, si dhe indiferentizmin e plotë të administratës publike vendore.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 27 Qershor 2013

ⁱⁱ Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- “KLSH dhe policia bashkiake” (Telegraf , 03 dhjetor 2013)